VENDIM
Nr. 286, datë 13.11.2025

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "DRAGOBIA ENERGY" SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "ç", dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "d", 5, pika 1, germa "d", 13, 16 dhe 14, pika 9, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2516/6 prot., datë 7.11.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Dragobia Energy' sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Dragobia Energy" sh.p.k., e licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 98, datë 16.4.2021, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 2516/1 prot., datë 16.10.2025, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 266, datë 27.10.2025, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 28.10.2025 dhe 29.10.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve, apo objeksioneve nga të tretët (data 6.11.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.
- ERE, me shkresën nr. 2515/4 prot., datë 29.10.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin, që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2516/5 prot., datë 4.11.2025, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacionin e munguar.
- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, ka shlyer pagesat e rregullimit ndaj ERE-s, si dhe ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar.
- Rezulton se shoqëria disponon aktualisht zyrat përfaqësuese të furnizuesit, por duke qenë se afati i marrëveshjes së huapërdorjes nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit, vlerësohet t'i lihet kusht depozitimi brenda datës 29.7.2027, i marrëveshjes së rinovuar për përdorimin e zyrave ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k. për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 17.4.2026.

2. Brenda datës 29.7.2027, shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.

3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të pikës 2.

4. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Dragobia Energy” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti